

# EPOKA ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXI, nr. 6381  
E premte, 6 gusht 2021  
çmimi 0.40 €

**Haxhiu: Lufta kundër  
korrupsionit dhe abuzimit  
me paranë publike,  
prioritet i qeverisë** | FAQE 5



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR ABBRUCH GMBH**  
www.awr-abbruch.de

## PDK-ja BËHET ME KRYESI TË RE

 | FAQE 3


Vlora Çitaku, Enver Hoxhaj, Uran Ismaili dhe Ramë Buja janë zgjedhur nënkryetarë të Partisë Demokratike të Kosovës. Emrat nënkryetarëve dhe anëtarëve të Kryesisë së re të

PDK-së janë propozuar para Këshillit Drejtues nga kryetari i PDK-së, Memli Krasniqi. Pjesë e Kryesisë së PDK-së janë edhe figura të reja, në mesin e tyre edhe ish-

ambasadori Bernard Nikaj. Po ashtu, pjesë e Kryesisë së PDK-së është edhe mbesa e ish-presidentit Hashim Thaçi, Evgjëni Thaçi-Drăgusha

INSTITUCIONET NË VEND BËJNË THIRRJE PËR KUJDES NGA ZJARRET

 | FAQE 3

## KOSOVA VAZHDON TË PËRBALLET ME DISA VATRA TË ZJARRIT

Vendi ynë vazhdon të përballët me disa vatra të zjarrit në disa lokalitete. Në të gjitha vatrat e zjarrit janë të angazhuara me kapacitet të plotë të gjitha institucionet përgjegjëse. Për shuarjen e zjarreve janë angazhuar: ekipet e zjarrfikësve, Policia e Kosovës, pjesëtarët e FSK-së, ndërmarrjet publike. Një ndihmë të madhe nga ajri janë duke e dhënë pjesëtarët e KFOR-it, të cilët nëpërmjet helikopterëve po ndihmojnë për shuarjen e zjarreve



### AKTUALE



**KËRKOHEN MË SHUMË GRA  
KANDIDATE PËR KRYETARË TË  
KOMUNAVE** | F. 4

**ZEMAJ: AS 10 PËR QIND E  
QYTETARËVE NUK JANË  
VAKSINUAR, KRYEMINISTËR  
PUNO!** | F. 5

**SALI BERISHA DORËZON  
PADINË KUNDËR ANTONY  
BLINKEN** | F. 2

**GJERMANIA DHE FRANCA  
INJOROJNË THIRRJEN E  
OBSSH-SË PËR DOZAT  
PËRFORCUESE TË VAKSINAVE** | F. 2

**POLICIA E RAJONIT TË  
PRISHTINËS SEKUESTRON 15  
ARMË ZJARRI NË AHENGJE  
FAMILJARE** | F. 7

### EKONOMI

**KEDS-I ANGAZHON 400  
PUNËTORË NË TERREN PAS  
ERËRAVE TË FUQISHME** | F. 8

**MINISTRIA E FINANCAVE DO TË  
BËJË SUBVENCIONIMIN E PAGËS  
PËR TRE MUJ PËR TË GJITHA  
TË PUNËSUARAT** | F. 8

**RENOVA**  
PUTZ  
Macedoni  
Xhepgjisht-Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.PK.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
www.princesha-ks.com

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
www.kolegji.biznesi.com  
info@kolegji.biznesi.com  
030 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

# Gjermania dhe Franca injorojnë thirrjen e OSh-së për dozat përforcuese të vaksinave

**BERLIN, 5 GUSHT** - Gjermania dhe Franca do të japin doza përforcuese të vaksinave kundër koronavirusit nga muaji shtator, duke vepruar në kundërshtim me thirrjet e Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OSh) për të pezulluar këto programe derisa të vaksinohen më shumë njerëz në botë.

Presidenti francez Emmanuel Macron ka thënë se Franca është duke punuar për të dhënë dozën e tretë të vaksinës për të moshuarit dhe ata që janë më të cenueshëm ndaj sëmundjes Covid-19 që shkakton ky virus. "Doza e tretë duket se do të jetë e domosdoshme jo për secilin menjëherë, mirëpo për ata që janë më të cenueshëm dhe më të moshuar", ka thënë Macron

përmes një postimi në "Instagram".

Gjermania, po ashtu, synon të japë doza përforcuese për personat më të moshuar dhe ata që jetojnë në shtëpi kujdesi, nga muaji shtator, ka thënë Ministria e Shëndetësisë në këtë vend.

Shefi i OSh-së, Tedros Adhanom Ghebreyesus, ka bërë thirrje të martën për të mos dhënë dozat përforcuese të paktën deri në shtator, duke thënë se është e papranueshme që shtetet e pasura të kenë më shumë doza vaksinash. "Shtetet me të ardhura të larta kanë dhënë 100 doza vaksinash për 100 banorë", ka thënë Tedros. "Në të njëjtën kohë, shtetet me të ardhura të vogla kanë dhënë 1.5 doza për 100 persona, sepse kanë mungesë të

tyre. Ne duhet të ndryshojmë këtë gjë urgjentisht, në mënyrë që shumica e vaksinave të ndahen për vendet me më pak të ardhura, dhe jo për ato më të pasurat".

Gjermania ka hedhur poshtë këto akuza, duke thënë se do të ndajë donacione prej rreth 30 milionë dozave të vaksinave për vendet e varfra.

Qeveria e Macronit, ndërkaq, është duke tentuar ta rrisë shkallën e vaksinimit teksa Franca përballet me valë të katërt të pandemisë, si dhe protesta në rrugë kundër politikave qeveritare ndaj krizës me koronavirus.

Deri më tani 49 për qind e francezëve dhe 53 për qind e gjermanëve janë të vaksinuar plotësisht kundër Covid-19.



## Sali Berisha dorëzon padinë kundër Antony Blinken



**TIRANË, 5 GUSHT** - Ish-kryeministri i Shqipërisë, Sali Berisha, ka dorëzuar në Gjykatën Korreksionale të Parisit padinë për shpifje ndaj sekretarit amerikan të Shtetit, Antony Blinken. "Kjo padi në gjykatë për shpifje bazohet në precedentë të mëparshme të ngjashme dhe në parimin universal se shpifja nuk ka imunitet sepse ajo nuk hyn në funksione zyrtare dhe, për rrjedhojë, imuniteti në rastin e shpifjes nuk mund të përdoret si mburojë", ka thënë të enjten Berisha në një konferencë për media.

Padia e Berishës vjen pasi Departamenti Amerikan i Shtetit

i ka ndaluar hyrjen në territorin amerikan atij dhe anëtarëve të familjes së tij të ngushtë për shkak të përfshirjes së tij në korrupsion të gjerë.

Në deklaratën e sekretarit amerikan të Shtetit, Antony Blinken, thuhej se Berisha, në cilësinë e tij zyrtare, në veçanti si kryeministër i Shqipërisë, ishte i përfshirë në veprime korruptive, të tilla si shpërdorim i fondeve publike dhe ndërhyrje në proceset publike.

Në anën tjetër, Sali Berisha të premten tha se vendimi i ShBA-së për ta shpallur person "non grata" është politik dhe pa baza, duke përsëritur se ndaj tij nuk

është publikuar asnjë fakt, pavarësisht prej kërkesës së bërë tre muaj më parë. "Kurrë s'e kisha menduar se do të detyrohesh të ngreh padi ndaj një sekretari të ShBA-së, të një vendi që e adhuroj kaq shumë", ka thënë ish-kryetari i Partisë Demokratike (PD). Ai u shpreh se kjo padi ndaj Blinken "është padi për dinjitetin njerëzor" dhe kundër "diktatit të barit", duke iu referuar deklaratave të disa ditëve më parë të ambasadores amerikane në Shqipëri, Yuri Kim, e cila kërkoi nga kryetari i Partisë Demokratike, Lulzim Basha, që kjo parti të distancohet nga Sali Berisha.

## Inicohen 22 raste në lidhje me mohimin e gjenocidit në Bosnje

**SARAJEVË, 5 GUSHT** - Që nga 28 korriku, kur hynë në fuqi ndryshimet në Kodin Penal të Bosnje e Hercegovinës (BeH) që ndalojnë mohimin e gjenocidit dhe krimeve të tjera të luftës, të vendosura nga ish-përfaqësuesi i lartë, Valentin Inzko, Prokuroria në Bosnje ka iniciuar 22 raste me akuza për këto krime.

Kjo u konfirmua për "Radion Evropa e Lirë" nga zëdhënësi i prokurorisë, Boris Grubeshiq, më 5 gusht. "Pas publikimit të vendimit të përfaqësuesit të lartë deri më sot, në Prokurori të Bosnjës dhe Hercegovinës gjithsej 22 raste janë hapur në bazë të raportimeve për mohimin e gjenocidit", ka thënë

Grubeshiq.

Shkelja e këtij ligji dënohet me burgim nga tre muaj deri në pesë vjet.

Përfaqësues të Republika Sërpskës nisën më 26 korrik bojkotimin e institucioneve qendrore të Bosnjës për shkak të ndryshimeve në Kodin Penal.

Pas vendimit të Inzkos dhe përpara vendimit për bllokimin e institucioneve shtetërore, anëtari serb i Presidencës trepalëshe të Bosnjës, Millorad Dodik, tha se Republika Sërpska "duhet ta fillojë procesin e shpërbërjes".

Pastaj, më 30 korrik, Asambleja Kombëtare e Republikës Srpska (NARS), në një seancë të mbyllur, miratoi Ligjin për



moszbatimin e vendimit për ndalimin e mohimit të gjenocidit me procedurë

urgjente.

Deputetët, po ashtu, miratuan ndryshime ligjore në bazë të të

cilave do të dënohen ata të cilët Republikën Sërpska e thërrasin si "krijim gjenocidial".

# PDK-ja bëhet me kryesi të re

Vlora Çitaku, Enver Hoxhaj, Uran Ismaili dhe Ramë Buja janë zgjedhur nënkryetarë të Partisë Demokratike të Kosovës. Emrat nënkryetarëve dhe anëtarëve të Kryesisë së re të PDK-së janë propozuar para Këshillit Drejtues nga kryetari i PDK-së, Memli Krasniqi. Pjesë e Kryesisë së PDK-së janë edhe figura të reja, në mesin e tyre edhe ish-ambasadori Bernard Nikaj. Po ashtu, pjesë e Kryesisë së PDK-së është edhe mbesa e ish-presidentit Hashim Thaçi, Evgjëni Thaçi-Drăgusha

**PRISHTINË, 5 GUSHT (ER)** - Partia Demokratike e Kosovës (PDK) ka zgjedhur të enjten Kryesinë e re. Para anëtarëve të Këshillit Drejtues, kryetari i PDK-së, Memli Krasniqi, ka paraqitur përbërjen e kësaj kryesie, ku nënkryetarë do të jenë: Vlora Çitaku, Ramë Buja, Enver Hoxhaj dhe Uran Ismaili, kurse anëtarë të Kryesisë së PDK-së do të jenë: Bernard Nikaj,

Donika Shahini, Jakup Nura, Bekim Qollaku, Nexhat Demaku, Evgjëni Thaçi-Drăgusha, Sokol Bashota, Besa Kabashi-Ramaj, Adri Nurellari, Rashit Qalaj, Zenun Pajaziti, Valdete Idrizi, Betim Gjoshi, Fehmi Mujota, Petrit Hajdari, Luljeta Veselaj-Gutaj, Blerand Stavileci, Muzaffer Shala, Muhamet Haliti, Kujtimi Gashi, Safete Hadergjonaj dhe Donjet



Bislimi. Pas zgjedhjes së kryesisë së re, kryetari i PDK-së ka mbajtur konferencë për media, në të cilën ka folur për ambicet e kësaj partie si parti opozitare. Më 3 korrik PDK-ja ka mbajtur

zgjedhjet për kryetar të partisë, ku Memli Krasniqi është zgjedhur në këtë pozitë pa kundër kandidat. Zgjedhjet në këtë parti janë organizuar pas situatës së krijuar me rastin e ngritjes së aktakuzës nga

Gjykata Speciale kundër ish-kryetarit të PDK-së, Kadri Veseli. Pas largimit të Veselit dhe deri në zgjedhjen e Krasniqit në krye të PDK-së, kjo parti është drejtuar nga Enver Hoxhaj.

INSTITUCIONET NË VEND BËJNË THIRRJE PËR KUJDES NGA ZJARRET

## Kosova vazhdon të përballet me disa vatra të zjarrit

Vendi ynë vazhdon të përballet me disa vatra të zjarrit në disa lokalitete. Në të gjitha vatrat e zjarrit janë të angazhuara me kapacitet të plotë të gjitha institucionet përgjegjëse. Për shuarjen e zjarreve janë angazhuar: ekipet zjarrfikëse, Policia e Kosovës, pjesëtarët e FSK-së, ndërmarrjet publike, kurse një ndihmë të madhe nga ajri janë duke e dhënë pjesëtarët e KFOR-it, të cilët nëpërmjet helikopterëve ppo ndihmojnë për shuarjen e zjarreve

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

**PRISHTINË, 5 GUSHT** - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka reaguar pasi që në disa rajone të Kosovës situata është rënduar nga zjarret dhe ky rrezik ende nuk ka kaluar. Sipas presidentes Osmani, institucionet e vendit me kapacitet të plotë po përplojnë për zvogëlimin e pasojave nga zjarret, por kjo përpjekje kërkon edhe mbështetjen e qytetarëve. "Në kohën kur temperaturat ekstreme kanë përfshirë vendin tonë, rreziku nga zjarret është rritur tej mase. Prej disa ditësh në disa rajone të Kosovës situata është rënduar nga zjarret dhe ky rrezik ende nuk ka kaluar. Institucionet e vendit me kapacitet të plotë po përplojnë për zvogëlimin e pasojave nga zjarret, por kjo përpjekje domosdoshmërisht kërkon edhe mbështetjen e qytetarëve. Zjarrfikësit, pjesëtarët

e Forcës së Sigurisë së Kosovës, pjesëtarët e Policisë së Kosovës, mbështetur edhe nga KFOR-i, po bëjnë të pamundurën, por të gjithë kemi përgjegjësinë që ta rritim kujdesin për ta ulur rrezikun nga shtrirja e zjarreve", ka thënë Osmani. Ajo ka theksuar se djegia e hamulloreve konsiderohet ndër shkaktarët kryesorë të zjarreve, ndaj ajo ka bërë thirrje që qytetarët duhet të përmbahen nga veprimet e tilla të cilat shkaktojnë rrezik të përgjithshëm. "Kosova është shtëpia jonë, ndaj të gjithë duhet të mobilizohemi ta ruajmë mjedisin dhe t'i ruajmë jetët e njerëzve tanë", ka thënë Osmani. Edhe kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, gjatë vizitës që i ka bërë komunës së Suharekës, e cila është përfshirë nga zjarri, ka bërë thirrje për kujdes të shtuar në këto ditë me temperatura shumë të larta. "Duhet të jemi shumë vigjilentë dhe të kujdesshëm,

meqenëse edhe sot, edhe nesër, edhe pasnesër, do të jenë temperaturat e larta dhe erërat e fuqishme e bëjnë shumë më të vështirë fikjen e zjarreve më pastaj", ka thënë Kurti. Komunitat që janë përfshirë nga zjarret janë: Suhareka, Malisheva, Drenasi, Peja, Istogu, Podujeva dhe Obiliqi. Ministria e Punëve të Brendshme ka njoftuar se në të gjitha vatrat e zjarrit janë të angazhuara me kapacitet të plotë të gjitha institucionet përgjegjëse të cilat po koordinohen nga Qendra Operative e MPB-së. Për shuarjen e zjarreve janë angazhuar: ekipet zjarrfikëse, Policia e Kosovës, pjesëtarët e FSK-së, ndërmarrjet publike. Një ndihmë të madhe nga ajri janë duke e dhënë pjesëtarët e KFOR-it, të cilët nëpërmjet helikopterëve po ndihmojnë për shuarjen e zjarreve.

**Ahmeti: Duhet të ndodhë vetëdijesimi i qytetarëve për rrezikun nga zjarret pyjore dhe fushore**

Njohësi i çështjeve të emergjencave dhe drejtori ekzekutiv i Qendrës Kërkimore për Politika të Sigurisë, Tahir Ahmeti, ka bërë me dije se institucionet qendrore dhe lokale duhet të përgatiten për



parandalimin e zjarreve fushore dhe pyjore. Ai ka deklaruar se këto institucione duhet ta bëjnë mobilizimin e stafit dhe sigurimin e pajisjeve të nevojshme për parandalimin e zjarreve. Ahmeti ka thënë se në këto raste duhet të ndodhë vetëdijesimi i qytetarëve për rrezikun nga zjarret pyjore dhe fushore. "Agjencia për Menaxhimin e Emergjencave, por edhe drejtoritë komunale për mbrojtje dhe shpëtim, duhet të bëjnë përgatitjet maksimale profesionale për parandalimin dhe zvogëlimin e këtyre zjarreve. Duhet të përfshihet komuniteti lokal i atyre zonave ku zakonisht ndodhin zjarret, qoftë me trajnime të pjesëtarëve të komunitetit, qoftë edhe me fletushka vetëdijesuese të përgatitura për mënyrën e parandalimit dhe luftimit të këtyre zjarreve", ka deklaruar Ahmeti. Ai ka vlerësuar se në këtë mënyrë do të ndihmohen zjarrfikësit të cilët në shumë raste, edhe pse bëjnë sakrificë të madhe, e kanë të vështirë luftimin e atyre zjarreve. Ahmeti ka treguar se Kosova ka mungesë të theksuar të

zjarrfikësve. Sipas tij, numri i vogël i stafit dhe pajisjeve jo të duhura e vështirësojnë punën e zjarrfikësve. "Në bazë të Ligjit për Zjarrfikje dhe Shpëtim, një zjarrfikës do të duhet të ishte për 1 500 banorë, ndërsa tani përfaqësojnë një zjarrfikës në Kosovë është për 2 800 - 3 000 banorë, pra kemi mungesë të theksuar të resurseve njerëzore. Kur kësaj i shtohet edhe ajo se edhe mjetet dhe pajisjet e zjarrfikësve nuk janë të nivelit që do të duhej të ishin, kjo edhe më shumë e vështirëson çështjen e menaxhimit të këtyre zjarreve", është shprehur Ahmeti. Njohësi i çështjeve të emergjencave ka treguar se në fushatat sensibilizuese duhen paralajmëruar qytetarët edhe për sanksionet që i presin për zjarrvnie të qëllimshme. "Duhet paralajmëruar qytetarët për sanksionet ndëshkuese nga shkaktimi i zjarreve të qëllimshme apo nga pakujdesia. Duke u bazuar në ligjet e Republikës së Kosovës, inicimi i zjarrit që është me rrezik të përgjithshëm është vepër penale dhe sanksionohet me burgim nga 6 muaj deri në 5 vjet", është shprehur ai.



INSTITUTI DEMOKRATIK I KOSOVËS (KDI) DHE RRJETI I GRAVE TË KOSOVËS (RRGK) KANË SHPREHUR SHQETËSIM PËR PËRFSHIRJEN E VOGËL TË GRAVE NË LISTAT ZGJEDHORE TË PARTIVE POLITIKE

# Kërkohen më shumë gra kandidatë për kryetare të komunave

Shoqëria civile ka kërkuar nga subjektet politike të kandidojnë më shumë gra për pozitën e kryetares së komunës. Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) dhe Rrjeti i Grave të Kosovës (RrGK) ua ka rikujtuar partive politike se barazia gjinore është obligim ligjor në zgjedhjet lokale. Sipas tyre, është shqetësuese që nga kandidatët për kryetar të komunave të zyrtarizuar deri më tani, gratë mbesin shumë pak të përfshira në listat zgjedhore të partive politike. Deri më tani vetëm LDK-ja ka kandiduar dy gra për pozitën e kryetares së komunës

**EPOKA  
ERE**

**Muhamet KOCI**

**PRISHTINË, 5 GUSHT** - Shoqëria civile ka kritikuar partitë politike për mosrespektim të barazisë gjinore për zgjedhjet lokale. Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) dhe Rrjeti i Grave të Kosovës (RrGK) kanë kërkuar nga subjektet politike që do të marrin pjesë në zgjedhjet lokale të 17 tetorit të kandidojnë më shumë gra kandidatë për kryetare të komunave.

Drejtori ekzekutiv i KDI-së, Ismet Kryeziu, ka bërë me dije se në zgjedhjet e kaluara lokale vetëm 17 gra kandidatë kanë garuar për postin e të parit të komunës. "Më shumë gra kandidatë për kryetare të komunave. Kosova ka pasur deri më tani vetëm një kryetare të komunës grua. Në dy palë zgjedhjet e fundit lokale ka pasur vetëm 17 gra kandidatë për kryetare të komunave, nga gjithsej rreth 450 kandidatë. Në vetëm në 12 komuna të Kosovës ka pasur të paktën një grua kandidatë për kryetare", ka shkruar Kryeziu në profilin e vet në "Facebook". Kurse Rrjeti i Grave të Kosovës (RrGK) ua ka rikujtuar partive politike se barazia gjinore është obligim ligjor në zgjedhjet lokale. "Rrjeti i Grave të Kosovës (RrGK) po përcjell me vëmendje të shtuar zyrtarizimin e kandidatëve për kryetar/e të komunave. Është shqetësuese që nga kandidatët e zyrtarizuar deri më tani, gratë mbesin shumë pak të përfshira në listat zgjedhore të partive politike. RrGK vlerëson përpjekjet e disa partive për të

kandiduar gra në garën për zgjedhje lokale. Sidoqoftë, përzgjedhja e deritanishme e shumicës së kandidatëve burra për kryetar të komunave është jashtëzakonisht problematike", ka vlerësuar RrGK-ja në një reagim për medie.

Sipas këtij rrjeti, kjo praktikë e ndjekur nga partitë politike është duke pamundësuar përfshirjen e grave në jetën publike dhe ndërtimin e një shoqërie më të barabartë. "RrGK-ja ua rikujton partive politike të Kosovës se neni 14 i Ligjit për Barazi Gjinore (LBGJ) i obligon ato që t'i zbatojnë masat për promovimin e pjesëmarrjes së barabartë të burrave dhe grave në organet dhe trupat e partive, në pajtim me dispozitat e nenit 6 të këtij ligji, i cili përcakton qartë se në ato raste kur ekzistojnë pabarazitë, duhet të merren masa të veçanta të përkohshme me qëllim të përshpejtimin të realizimit të barazisë faktike ndërmjet grave dhe burrave në ato fusha ku ekzistojnë pabarazi. Prandaj, është e domosdoshme që të respektohet ky ligj dhe të krijohen kushtet që gratë të kenë mundësi që në mënyrë të barabartë me burrat të marrin pjesë në proceset vendimmarrëse", ka vlerësuar rrjeti, duke shtuar se zgjedhjet parlamentare të 14 shkurtit kanë treguar për një pjesëmarrje të madhe të grave në procesin zgjedhor, gjë që ka sjellë rritje të numrit të grave në përfaqësimin politik. "Përmes votës qytetarët treguan që duan më shumë gra



në pozita udhëheqëse andaj partitë politike, përveç respektimit të LBGJ-së, e kanë për obligim ta respektojnë këtë vullnet dhe të ofrojnë më shumë hapësirë për gratë në zgjedhje lokale. Teksa afatet po ngushtohen dhe brenda partive ende po diskutohet për kandidaturat e mundshme, RrGK edhe një herë u bën thirrje të gjitha partive politike që të kandidojnë sa më shumë gra për kryetare të komunave në zgjedhjet lokale dhe t'i përmbahen standardit të përfaqësimit minimal prej pesëdhjetë përqindësh (50 përqind) në pajtim me kushtet e parapara me Ligjin për Barazi Gjinore", ka bërë me dije RrGK-ja.

Sipas këtij rrjeti, duhet

siguruar përfaqësim politik edhe për gratë me aftësi të kufizuara si dhe grave të komuniteteve joshumicë. "Ne kërkojmë që partitë politike të angazhohen për të ofruar hapësirë për gratë në këto zgjedhje lokale duke krijuar mundësi për përfshirje në përfaqësim politik edhe të grave me aftësi të kufizuara, grave rome, ashkalike, egjiptiane, gorane dhe serbe të cilat nuk janë të përfaqësuara fare. Gratë kanë nevojë dhe ide të ndryshme, dhe për një udhëheqje gjithëpërfshirëse, është e domosdoshme përfaqësimi i tyre në organet vendimmarrëse. Ua rikujtojmë partive politike në Kosovë se përfshirja e grave në proceset vendimmarrëse është një hap i

rëndësishëm në përpjekjen për të ndërtuar një shoqëri të drejtë dhe të barabartë", ka vlerësuar RrGK-ja.

**Lëvizja Vetëvendosje ende nuk ka zyrtarizuar asnjë kandidat për kryetar komunash**

Partia më e madhe në vend, Lëvizja Vetëvendosje, deri më tani nuk ka zyrtarizuar asnjë kandidat në asnjërën prej komunave të Kosovës. Ndryshe nga LV-ja, tri partitë opozitare PDK-ja, LDK-ja dhe AAK-ja deri më tash kanë zyrtarizuar shumicën e kandidatëve për kryetar të komunave. PDK-ja deri më tani ka

zyrtarizuar 11 kandidatë për kryetarë komunash, ndërkaq kanë mbetur pa zyrtarizuar kandidatët në Deçan, Gjakovë, Gjilan, Dragash, Istog, Klinë, Lipjan, Obiliq, Rahovec, Suharekë, Podujevë, Viti, Vushtrri, Malishevë, Junik, Hani i Elezit dhe Mamushë. Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) ka zyrtarizuar 19 kandidatë. Kjo parti ende nuk i ka bërë zyrtare kandidatët për kryetarë në Gjakovë, Drenas, Kaçanik, Obiliq, Skenderaj, Shtime, Mitrovicë, Hani i Elezit dhe Mamushë. LDK-ja është e vetmja parti që deri më tani ka prezantuar dy gra për kryetare të komunave. Kjo parti ka zyrtarizuar Sibel Halimin për kryetare të komunës së Ferizajt dhe Hyrije Dobrunaj për kryetare të komunës së Deçanit. Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës deri më tani ka zyrtarizuar 15 kandidatë për

kryetarë komunash. AAK-ja ka mbetur pa zyrtarizim të kandidatëve në Drenas, Dragash, Kaçanik, Fushë-Kosovë, Lipjan, Prizren, Skenderaj, Shtime, Viti, Malishevë, Mitrovicë, Hani i Elezit dhe Mamushë. Derisa partitë politike vazhdojnë t'i prezantojnë kandidatët e tyre nëpër komuna, edhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është duke pranuar aplikimin e subjekteve politike për t'u certifikuar për pjesëmarrje në zgjedhjet lokale të 17 tetorit. Afati për certifikim të subjekteve politike si dhe për dorëzimin e listës me emrat e kandidatëve për kryetar komune apo për kuvende komunale përfundon më 16 gusht. Zgjedhjet lokale do të mbahen më 17 tetor, kurse subjektet politike kanë 30 ditë kohë për të bërë fushatë zgjedhore.

## Kosova regjistron edhe dy viktima dhe 195 raste të reja me Covid

PRISHTINË, 5 GUSHT (ER) - Në Kosovë të enjten u regjistruan dy viktima dhe 195 raste të reja me Covid. Viktimat janë nga komuna e Prizrenit dhe e Suharekës.

Rastet e reja me Covid-19 dalin pas testimit të 3 730 mostrave. Sipas të dhënave, numri më i madh i rasteve të reja i përket grupmoshës 20-29 vjeç, përkatësisht 56 raste. Ndërkaq, nga moshë 0 deri 19 vjeç janë regjistruar 23 raste me koronavirus.

Gjatë 24 orëve paraprake janë shëruar 16 pacientë, ndërkaq raste aktive janë 1 065.

Që prej 13 marsit të vitit 2020 deri më 5 gusht 2021 në Kosovë janë regjistruar 109 039 raste me Covid-19, 2 270 të vdekur



dhe 105 704 pacientë të shëruar. Ndërkaq, sa iu përket testeve, që prej fundit të marsit deri më 5 gusht, në Kosovë janë administruar 469 857 doza. Prej

kësaj shifre, 305 567 persona janë vaksinuar me një dozë, ndërkaq me dy dozat e vaksinës janë vaksinuar 164 290 persona.

## Haxhiu: Lufta kundër korrupsionit dhe abuzimit me paranë publike, prioritet i qeverisë

PRISHTINË, 5 GUSHT (ER) - Ministria e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, ka thënë se lufta kundër korrupsionit dhe abuzimit me paranë publike është prioritet i Qeverisë së Kosovës. Në këtë drejtim, ajo ka thënë se adresimi i shkeljeve është shumë i rëndësishëm si për parandalimin e dukurive të tilla, po ashtu edhe për adresimin e shkeljeve ligjore. "Me miratimin e Ligjit për Mbrojtjen e Sinjalizuesve dhe, së fundmi, edhe të Rregullores për Trajtimin e Rasteve të Sinjalizimit, e kemi kompletuar legjislacionin i cili është tejte i avancuar. Ky legjislacion garanton mbrojtje të sinjalizuesve, të qytetarëve të ndërgjegjshëm, të cilët nuk heshtin karshi dukurive negative", ka thënë të enjten Haxhiu.

Ajo ka theksuar se njoftimi i zyrtarëve me të drejtat që u garanton legjislacioni ynë është një aspekt me shumë rëndësi, i cili mundëson zbatim të legjislacionit të kësaj fushe, rrjedhimisht mundëson sinjalizim. "Në këtë javë mbajtëm sesione njoftuese për stafin e Ministrisë së Drejtësisë për të drejtat e sinjalizuesve dhe i inkurajua t'i raportojnë parregullsitë, vendosëm njoftime nëpër hapësira të ministrisë ku, përveç njoftimit me të drejtat, e njoftuam stafin edhe me adresën ku mund të paraqiten shkeljet, përgatitëm dhe dërguam njoftime të gjithë zyrtarët e institucioneve shtetërore. Të nderuar zyrtarë, mos hezitoni, sinjalizoni", ka deklaruar ministria e Drejtësisë, Albulena Haxhiu.



## Zemaj: As 10 për qind e qytetarëve nuk janë vaksinuar, kryeministër puno!



PRISHTINË, 5 GUSHT (ER) - Ish-ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, ka folur rreth situatës me pandeminë Covid-19 në vend. Ai ka drejtuar kritika në adresë të qeverisë Kurti, duke theksuar se pandemia nuk është lojë. "Kryeministër, pandemia nuk është lojë. Virusi ishte dhe është në mesin tonë, ndaj tento të punosh. Veç një herë në jetën tënde vendos dhe tento të punosh. Tento, mos u frikëso!",

ka shkruar Zemaj në llogarinë e vet në "Facebook".

Zemaj ka thënë se deklaratat pa punë janë veç fjallë të thata e të pamatura si dhe kanë kosto për qytetarët. "Sipas Kurtit, virusi vetvetiu do të duhej të hiqej pas 14 shkurtit, por ja që nuk ndodhi. Ai kishte deklaruar e ishte lavdëruar se pandeminë e munda, mirëpo dje, nga 9 raste, i kemi 221 raste të reja me Covid-19. Përkthyer ndryshe, është një rritje prej afërsisht 2

500 për qind. Kryeministër, aman përvjeli mëngët, e jo 'mindilin', se nuk bën, nuk funksionon, besomë. Me 'mindilin' tënd mundesh veç të qash me lot, se për ta menaxhuar pandeminë e ke të kotë", ka deklaruar Zemaj, duke theksuar se pandemia nuk menaxhohet me retorikë boshe. "Mos të harroj që ta kujtoj se as 10 për qind të qytetarëve nuk i ke të vaksinuar. Shtatori po vjen!", ka shkruar Zemaj.

## Vazhdon bashkëpunimi i komunës së Prizrenit me policinë

PRIZREN, 5 GUSHT (ER) - Pas rregullimit të zyrës së policisë në qendrën historike të Prizrenit dhe inventarizimit të saj dhe renovimit të kulmit të Stacionit të Policisë së Trafikut, tash së fundmi, në

bashkëpunim me bizneset "Puntex" dhe "Dardania Sport", është bërë furnizimi i Njesisë së Trafikut dhe të biçiklistëve të policisë me këpucë dhe uniforma. Kryetari i komunës së Prizrenit, Mytaher Haskuka,

ka falënderuar donatorët dhe policinë për bashkëpunimin e mirëfilltë. "Shpresojmë që ky bashkëpunim të kthehet në siguri më të lartë për qytetarët e komunës sonë", ka thënë kryetari Haskuka.



## Demos dhe komuna Mitrovicës diskutojnë për identifikimin e grupeve të marginalizuara



MITROVICË, 5 GUSHT (ER) - Nën mbështetjen e Demosit në Mitrovicë është mbajtur takim me zyrtarët komunalë, ku është diskutuar lidhur me identifikimin e grupeve të marginalizuara në nivel

komunal. Të pranishëm në këtë takim ishin drejtoresha për Integritet Evropian dhe Mirëqenie Sociale, Fitore Mehmeti Behrami, drejtoresha për Mbrojtjen e Mjedisit, Aida Ferati Doli, udhëheqësi i Njesisë

për të Drejta të Njeriut, Fitim Rama, përfaqësues nga Demosi si dhe zyrtarë të tjerë komunal. Gjatë këtij takimi përfaqësuesja nga Demosi, Adelina Hasani, ka ofruar mbështetje për komunën e Mitrovicës për identifikimin e

grupeve të marginalizuara. Ndërsa nga pjesëmarrësit e pranishëm është diskutuar për politikën dhe strategjitë komunale për identifikimin e këtyre grupeve. Në fund të këtij takimi është

potencuar se është më se e domosdoshme që komunat të kenë një databazë e cila do t'i identifikojë grupet më të cenueshme dhe më të marginalizuara në nivel komunal.

## Shtabi Emergjent në Podujevë diskuton për situatën me Covid, bëhet thirrje për vaksinim



PODUJEVË, 5 GUSHT (ER) - Shtabi Emergjent i komunës së Podujevës është mbledhur për të diskutuar për gjendjen aktuale me Covid-19. Lidhur me situatën dhe shifrat e fundit të të infektuarëve, ka folur drejtori i Drejtorisë së Shëndetësisë, Driton Veliu, i cili ka thënë se vetëm në shtatë ditët e fundit janë 49 raste të reja me Covid. Veliu ka thënë se varianti më i ri virusit 'Delta' ka përhapje shumë më të shpejtë sesa versioni origjinal i virusit. Ai ka theksuar se ky fakt ka bërë që edhe një numër i madh i qytetarëve në komunën e Podujevës të


vaksinohen. Sipas drejtorit Veliu, deri më tani janë të vaksinuar 19 148 persona të moshës mbi 18 vjet, që do të thotë rreth 21-22 për qind e popullsisë në nivel të komunës së Podujevës. Veliu ka thënë se Qendra për Vaksinim po funksionon me katër epike dhe numri i të vaksinuarëve brenda ditës është 800-850 persona. Lidhur me situatën e krijuar diskutuan edhe me anëtarët e tjerë të shtabit të cilët u pajtuan për koordinim të veprimeve të përbashkëta me qëllim të mbrojtjes së shëndetit të qytetarëve nga Covid-19.

## Haziri kërkon vigjencë nga qytetarët pas rritjes së numrit të rasteve me Covid

GJILAN, 5 GUSHT (ER) - Kryetari i komunës së Gjilanit, Lutfi Haziri, ka konfirmuar se, përkundër dyfishimit të numrit të banorëve pas ardhjes së mërgimtarëve, situata epidemiologjike mbetet në kontroll. Por, ai ka

kërkuar vigjencë nga qytetarët, duke u bërë thirrje të festojnë me kujdes. "Përkundër dyfishimit të numrit të banorëve pas ardhjes së mërgimtarëve, situata epidemiologjike mbetet nën kontroll. Kemi

një rritje të lehtë të infeksionit me variantin 'Delta' Covid dhe ky është kërcënim për shëndetin publik. Ju lutem shumë, festoni e çmalluni me familjet tuaja, por me kujdes", ka thënë Haziri.



## ShBA-ja dhuron pajisje mjekësore për Kosovën në vlerë 300 mijë dollarësh

PRISHTINË, 5 GUSHT (ER) - Shërbimi Spitalor Klinik dhe Universitar i Kosovës (ShSKUK) ka pranuar donacion në vlerë prej 300 mijë dollarësh nga Zyra për Bashkëpunim dhe Mbrojtje në Ambasadën Amerikane në Prishtinë.

Ky donacion është dhuruar në kuadër të ndihmesës për luftimin e pandemisë së Covid-19. Në ceremoninë e pranimit morën pjesë ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia dhe drejtori i ShSKUK-së, Valbon Krasniqi.

Donacionin e dorëzuan Major Ryan D. Connley, shef i Zyrës për Bashkëpunim dhe Mbrojtje në Ambasadën Amerikane në Prishtinë, Major Ryan D. Conley,

atashe i Zyrës. Pas pranimit të këtij donacioni, ministri Vitia ka thënë se ky donacion tregon se sa me rëndësi është solidariteti në mes nesh dhe miqve ndërkombëtarë. Sipas tij, këto pajisje të reja do të ndihmojnë profesionistët shëndetësorë në punën e tyre.

Major Ryan D. Conley lavdëroi punën e punëtorëve shëndetësorë, duke shtuar se pajisjet e dhuruara do t'i ndihmojnë profesionistët shëndetësorë për ta përballuar më lehtë valën e re të mundshme të pacientëve me Covid.

Donacioni përfshinë: ultrazë, monitorë për pacientë, flometra, rregullatorë të oksigjenit, CPAP maska, analizatorë të gazrave.



## Policia e rajonit të Prishtinës sekuestron 15 armë zjarri në ahengje familjare

EPOKA  
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 5 GUSHT - Nisur nga fakti se ende është i pranishëm si dukuri, përdorimi i armëve të zjarrit në ndeja dhe ahengje të ndryshme, strukturat operative rajonale të policisë po vazhdojnë punën për parandalimin e kësaj dukurie.

Që nga data 10 korrik 2021 deri sot policia e rajonit të Prishtinës ka sekuestruar 15 armë zjarri të cilat dyshohet të jenë përdorur në ahengje familjare. "Si

rjedhojë e veprimeve policore, mbrëmë në fshatin Sharban janë gjetur dhe sekuestruar: një pushkë automatike AK 47, një karikator i armës AK 47 dhe 59 gëzhoja armës AK47", ka njoftuar Policia e Kosovës.

Pas përfundimit të procedurave dhe konsultimit me prokurorin kujdestar të krimeve të rënda, rasti është cilësuar si përdorim i armës dhe mjetit të rrezikshëm dhe mbajtur në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve. "Policia e rajonit të Prishtinës, konform detyrimit

ligjor që ka, obligohet që në rastet e tilla ta fillojë kërkimin për armët e përdorura në rast, t'i ndalojë kolonat e dasmorëve për t'i kontrolluar ato dhe personat e dyshuar dhe në situata të caktuara të kryejë edhe bastisje në shtëpitë ku dyshohet për raste të tilla. Andaj, mbështetur mbi këtë bazë, u bëjmë thirrje të gjithë qytetarëve që t'u shmangen veprimeve të tilla për arsye të sigurisë së tyre, sigurisë së të tjerëve dhe ceremonitë festive t'i kalojnë pa ndonjë incident", ka njoftuar Policia e Kosovës.

## Certifikohen 15 pjesëtarë të FSK-së në fushën e shëndetit mendor

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 5 GUSHT - Në Ministrinë e Mbrojtjes të enjten është mbajtur ceremonia e certifikimit të 15 pjesëtarëve të Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), të cilët kanë përfunduar trajnimin në fushën e shëndetit mendor.

Në këtë ceremoni kanë marrë pjesë ministri i Mbrojtjes, Armend

Mehaj, komandanti i FSK-së, generallejtënant Rrahman Rama, drejtori i Departamentit të Mjekësisë, kolonel dr. Xhevdet Tahiraj, ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia, drejtori i ShSKUK-së, Valbon Krasniqi, drejtori i Klinikës së Psikiatrisë, dr. Shaban Mecinaj, si dhe ekipi profesional trajnues i klinikës përkatëse.

Në fjalën e tij, ministri Mehaj ka theksuar se krijimi i kapaciteteve

të profesionistëve të FSK-së për trajtimin e shëndetit mendor, sipas praktikave të ushtrive të vendeve të NATO-s, ka qenë prioritet i tij që me fillimin e punës si ministër i Mbrojtjes.

Gjithashtu, ai ka vlerësuar se për ushtarakun profesionist, sa e rëndësishme është përgatitja profesionale ushtarake dhe shëndeti fizik, po aq i rëndësishëm është edhe shëndeti

mendor. "Ndër objektivat e mi, ndër të tjera, është zhvillimi dhe avancimi i politikave në funksion të kujdesit shëndetësor dhe mirëqenies së plotë dhe të përhershme të ushtarakëve tanë", ka thënë ministri Mehaj.

Mehaj ka uruar pjesëtarët e trajnuar duke i udhëzuar që njohuritë e fituara t'i bartin te njësitë dhe kolegët e tyre gjatë shërbimit të përditshëm, stërvitje

si dhe operacione brenda dhe jashtë vendit.


Në fjalimet e tyre edhe ministri Vitia, gjeneral Rama, drejtori Krasniqi dhe kolonel Tahiraj kanë vlerësuar lart idenë e ministrit Mehaj, të konkretizuar me sukses dhe shprehën pajtueshmëri të plotë që bashkëpunimi i ndërsjellë, sikur edhe në fushat e tjera, të vazhdojë edhe në të ardhmen.

## KEDS-i angazhon 400 punëtorë në terren pas erërave të fuqishme

PRISHTINË, 5 GUSHT (ER) - Pas përkeqësimit të motit dhe erërave të fuqishme që kapluan vendin në orë të para të mëngjesit të së premtes, KEDS-i ka angazhuar 400 punëtorë në terren për të intervenuar në zonat e rrezikuara. "Dhjetëra ekipe tona janë shpërndarë gjithandej vendit ku po bëjnë çmos që të sanojnë dëmet e shkaktuara në rrjet sa më shpejt që është e mundur. Ekipet po punojnë pa

ndërprerë, me të gjitha kapacitetet në dispozicion, në mënyrë që konsumatorëve t'u rikthehet furnizimi me energji elektrike. Përkundër kushteve atmosferike, puna është duke u zhvilluar me dinamikë të lartë nga ekipet tona. KEDS-i është duke bërë monitorimin e rrjetit në kohë reale përmes programit 'Kosovanet', ku evidentimi i avarive po bëhet në kohë rekorde, ndërkaq përmes sistemit SCADA po

mundësohet kontrollimi i nënstacioneve dhe intervenimi më i shpejtë nga ekipet tona", është thënë në komunikatën e KEDS-it. KEDS-i u ka bërë thirrje qytetarëve që të bashkëpunojnë me ekipet në terren dhe nëse shohin ndonjë avari në rrjet, ta raportojnë atë përmes Qendrës së Thirrjes në numrin pa pagesë: 0800 791 00 dhe në rrjetet sociale të kompanisë.



# Ministria e Financave do të bëjë subvencionimin e pagës për tre muaj për të gjitha të punësuarat

PRISHTINË, 5 GUSHT (ER) - Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve, Hekuran Murati, ka nënshkruar vendimin për përcaktimin e kriterëve dhe kushteve lidhur me operacionalizimin e masës 1.3 të Pakos së Ringjalljes Ekonomike - Mbështetja e punësimit të grave. Në njoftimin e bërë për media thuhet se "kjo masë reflekton edhe një ndër prioritetet e Qeverisë së Republikës së Kosovës që qëllim kryesor ka fuqizimin e grave në tregun e punës. Punësimi i grave është tejet i rëndësishëm ashtu që të kemi një rritje ekonomike gjithëpërfshirëse dhe shoqëri përparimtare".

"Përmes masës 1.3, secilës prej grave të punësuar do t'i bëhet subvencionim i pagës deri në 50 % (pesëdhjetë për qind) të pagës bruto mujore për 3 (tre) muaj, duke filluar nga periudha tatimore korrik 2021 e tutje. Pas përfundimit të periudhës tremujore, do të subvencionohen kontributet pensionale për muajt e mbetur konform kriterëve dhe kufizimeve të përcaktuara me vendimin për zbatimin e masës 1.2 të Pakos së Ringjalljes Ekonomike. Kusht për subvencionim është që e



punësuarat të mos figurojnë në deklaratën e muajit qershor 2021 në ATK", thuhet në njoftim. Për të përfituar nga subvencioni, punëtorët e reja duhet të

deklarohen nga punëdhënësi në deklaratën e rregullt mujore që dorëzohet në sistemin elektronik EDI të ATK-së. Pasi të jetë bërë deklarimi, punëdhënësi duhet ta

plotësojë formularin e kërkesës për subvencionim, po ashtu përmes sistemit EDI. Aplikimi për subvencionim nga Masa 1.3 do të mund të bëhet

deri më 15.10.2021. Për hapjen dhe udhëzuesin e aplikimit, Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve do ta njoftojë publikun gjatë ditëve në vijim.

## Nuk lejohen mediat gjatë raportimit të KOSTT-it, opozita: Kjo ndodh vetëm në vendet komuniste

PRISHTINË, 5 GUSHT (ER) - Bordi dhe menaxhmenti i KOSTT-it kanë raportuar të enjten në Komisionin për Ekonomi, Ndërmarrësi, Industri dhe Tregti, por mediat nuk janë lejuar të qëndrojnë brenda gjatë këtij raportimi. Nga deputetja Mimoza Kusari-Lila u propozua që gjatë këtij raportimi mediat mos të jenë të pranishme, me arsyetimin se në bazë të rregullores janë disa gjëra që duhet të mbesin

konfidenciale. Deputeti i AAK-së, Pal Lekaj, ka thënë se është kundër mbylljes së raportimit për media. "Është e palogjikshme të mbahet një raportim i tillë pa praninë e mediave", ka theksuar Lekaj, duke shtuar se vetëm në komunizëm mund të ndodhë një gjë e tillë. Edhe deputetja e LDK-së, Valentina Bunjaku-Rexhepi, ka thënë se nuk e sheh të

arsyeshme që të mohohet një raportim i tillë para mediave. Deputetja Mimoza Kusari-Lila ka thënë se kjo kërkesë për mbylljen për mediat është e bazuar në rregullore dhe gjithçka do t'u transmetohet më vonë edhe mediave. Pas diskutimit mes deputetëve të pozitës dhe opozitës, me gjashtë vota për u votua që mediat të largohen gjatë raportimit të KOSTT-it.





# Lutje për imbecilët



**Nga: Giovanni PAPINI**  
**Përktheu: Aurel PLASARI**

Ju jeni të nevojshëm për shoqërinë e për vetë ne, dhe ia lejojmë vetes t'ju jemi mirënjohës. Pa ju nuk do të kishte hije për dritën tonë; nuk do të kishte pikë referimi për masën tonë; nuk do të kishte gur krahasimi për vlerën tonë. Pa ju do të na mungonin më të mëdhatë rehatira të jetës sonë dhe, gjithë vepra jonë, po të mos qenkësh e rrethuar nga mosmiratimi juaj, do të ngjante e pashije dhe banale si një lëvdatë. Ne kemi nevojë për ju. Ju jeni viktimat e kënaqësisë sonë dhe tabani i madhështisë sonë. Ju jeni zhytur që ne të mund të ngrihem; ju kemi ulur e përlurur që ne të mund të ngitemi. Më lejoni që të lutem për shpirtin tuaj, imbecilë të bindur e të panumërt. Kur ju kundroj të ulur në tryezën e një kafeneje të ndriçuar mirë, –

fytyrat tuaja kanë nevojë për shumë dritë, – kur ju vështroj nëpër rrugë e nëpër teatro, nëpër shitore e nëpër tramvaje, një dhimbshuri e madhe dhe e papërballueshme më pushton dhe mezi përmbahem që të mos ju hedh krahët në qafë e t'ju puth duart. Në ato çaste mëshira ime është përnjëmend e pafund dhe më duhet ta fsheh nën vrazhdësinë më brutale për të mos ju poshtëruar më shumë nga sa duhet.

Kur mendoj se sa gjëra ju mungojnë dhe do t'ju mungojnë për tërë jetës; sa emocione nuk ndjeni; sa aspekte të sendeve nuk i dalloni; sa të vërteta nuk i rrokni; sa bukuri ju ikën dhe sa kurajë ju mungon, atëherë mua, që nuk i kam lotët të lehtë, do të ma kishte vërtetë enda të shkrehesha në lot. Unë e di që ju kaloni nëpër botë pa e përkapur atë në qëndrueshmërinë dhe ndryshmërinë e saj; pa u ndalur

për të soditur ato gjëra të imta që janë më të mëdhatë në hemisferën e poezisë; pa depërtuar në shpirtin e grave tuaja dhe as në atë të miqve tuaj dhe, madje, as në shpirtin pafundësisht të vogël tuaj.

Unë e di që gjeniu mund t'ju kalojë përbri, prej mishi e eshtrash, prej fjalësh e fryme, dhe që ju nuk e shikoni, nuk jeni të aftë ta shikoni, t'i afroheni, t'i flisni, të shkoni me të, të lini mëmë e at dhe çdo pasuri të parëndësishme për ta ndjekur në ferrin e ëndjeve të tij të ndaluar.

E di që katër, pesë, dhjetë ide ju mjaftojnë për gjithë jetën, ju shërbejnë për të gjitha nevojat e përditshme, për ditën e për natën, për dashnoren e për berberin, për të folur e për të shkruar, për t'u ngritur në mëngjes e për të rënë në shtrat në mbrëmje dhe që në trurin tuaj pa dritare nga ana e qiellit nuk kanë të drejtë hyrjeje veçse të vërtetat e bëra stereotipi

dhe idetë që, nga përdorimi i shumë, janë shndërruar në imbecilitete.

Unë i di të gjitha këto, – dhe shumë të tjera që nuk i them për të mos prishur gjuhën, – prandaj a nuk do të duhet të më vijë keq për ju nga thellësia e zemrës? Mos pandehni se jam i lig dhe se po ushtrohem në sarkazmë. Unë ju dua sepse ju jeni kundërpesha e domosdoshme e të paktëve dhe keqardhja ime nuk ka asnjë nënkuptim. Dhe ju dua, poshtërsisht, edhe sepse kam frikë nga afërsia juaj.

Përrjetoj në jetën time orë të tmerrshme, në të cilat më duket se udhëtoj me pak arianë eksploratorë në mes mijëra tribush njerëzish të egër, në mes një kontinenti ku fetishi është gjithë filozofia dhe kanibalizmi fjala e fundit e dashurisë. Por kjo ndjesi mizore nuk zgjat. Ju jeni të padëmshëm edhe në mizorinë tuaj. Fytyrat tuaja të shushatura na

bëjnë mirë: janë thirrje e pareshtur për vigjilencë, për të synuar madhështinë që është e vetnja detyrë jona.

Ju jeni të huaj ndaj poezisë – sa qartë dallohet! – dhe prandaj nuk keni imagjinatë dhe nuk i dini sekretet e torturave cerebrale. Fjalët tuaja – edhe kur shpotisin e mohojnë – janë shoqërimi i nevojshëm i këngës sonë të luftës dhe na shpien drejt rrezikut të përleshjes më shumë se urdhrat e shkurtër të komandantëve tuaj.

Ju, krejt padashur, na bëni aq mirë! Ç'aromë që ka përçmimi juaj! Si gjallëron dhe eksciton urretja juaj! Përçmonani dhe urrenani gjithnjë më shumë, më me vrull, më me vendosmëri: sharjet tuaja janë shpëtimi ynë dhe bërja jonë pis është filtri që na bën më të rinj. Ne jemi këtu gati për të pritur goditjet tuaja; i presim pështymat tuaja si stërpikje uji të bekuar dhe i përmendim plagët tona si pengje shpërblimi.

**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT  
PILKINGTON  
Envert  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE  
'BUJQËSIA'  
TEL: 045/82 82 82**

# Eroll Salihu largohet nga pozita e sekretarit të FFK-së, merr dy pozita të reja



PRISHTINË, 5 GUSHT (ER) - Sekretari gjeneral i Federatës së Futbollit të Kosovës, Eroll Salihu ka dhënë dorëheqje. Lajmin e ka konfirmuar FFK-ja nëpërmjet një njoftimi për medie. Salihu është emëruar drejtor për çështje sportive dhe këshilltar senior ligjor. “Me kërkesën e veçantë të sekretarit të përgjithshëm Eroll Salihu, KE e liroi nga detyra e Sekretarit të përgjithshëm dhe e emëroi si drejtor për çështje sportive – këshilltar senior ligjor. Salihu e falënderoi KE dhe presidentin Ademi, duke potencuar se ka shërbyer për 15 vjet si Sekretar i përgjithshëm dhe tash dëshiron t’i kthehet çështjeve profesionale sportive dhe ligjore. Duhet të theksohet se z. Salihu është anëtar i Komitetit Ligjor të UEFA-s dhe kryetar i Këshillit të Arbitrazhit Sportive në KOK-ut ku do të vazhdojë edhe më tutje”, thuhet në njoftimin e FFK-së.

Gjithashtu në mbledhjen e mbajtur të enjten, Komiteti Ekzekutiv i FFK-së shqyrtoi përgatitjet për fillimin e kampionatit të ri 2021/2022 dhe konstatoi se përgatitjet po shkojnë sipas dinamikës së paraparë. KE shqyrtoi edhe ecurinë e përgatitjes së aftësisë dhe instalimit të sistemit VAR, duke konstatuar se aftësimi i kuadrit dhe instalimi i VAR-it do të fillojë me ndeshjen e Superkupës, ndërmjet Prishtinës dhe Llapit, e cila do të zhvillohet më 17 gusht në stadiumin “Fadil Vokrri” dhe do të vazhdojë me ndeshjet e Superligës. Me këtë rast KE falënderon ekipin e VAR-it për një angazhim të jashtëzakonshëm në mënyrë që sistemi i VAR-it të fillojë me kohë, e ku FFK-ja është e para në rajon që ka arritur me një kohë rekorde të instalojë këtë sistem që është tepër i dobishëm dhe ndihmesë e madhe për gjyqtarët e që kontribuon në

mbarëvajtjen garave. KE po ashtu miratoi vendimin që edhe në edicionin e ri 2021/2022, të drejtën televizive t’ia japë kompanisë “ArtMotion” për ndeshjet e Superligës dhe Ligës së Parë. KE po diskuton për një marrëveshje për sponsorizimin e Superligës me BKT-në dhe për zhvillimin e Platformës digjitale për klube. KE është në bisedime për sponsorizim të Ligës së Parë me VIVA-Fresh. KE është afër arritjes së Marrëveshjes për sponsorizim edhe të Ligës së Femrave dhe të gjyqtarëve të futbollit me Bankën Ekonomike. Gjithashtu Kompania “Fit-together” do të sponsorizojë Kombëtaren A dhe Superligën me mjete që mundësojnë matjet vitale të parametrave gjatë stërvitjeve dhe ndeshjeve për futbollistë. Me qëllim të zhvillimit më të mirë të futbollit, KE mori vendim për krijimin e Ligës U21.

## SHKURT

### Vëllaznimi transferon Haxhaj dhe Bërbatovcin

Skuadra e Vëllaznimit nga Gjakova ka vazhduar edhe të enjten përf forcime. Ish-futbollistët e Prishtinës, Adnan Haxhaj dhe Florim Berbatovci, e kanë përfuruar skuadrën kuqezi nga Gjakova. “KF Vëllaznimi ka arritur marrëveshje me qendërmbrojtësin Adnan Haxhaj. Haxhaj ka shumë përvojë në disa klube si: Prishtina, Vllaznia - Shkodër, Llapi, Liria, Ferizaj, Besa, së fundmi në FC KEK. Haxhaj ka nënshkruar kontratë njëvjeçare me klubin. Klubi ka arritur marrëveshje edhe me qendërsulmuesin Florim Bërbatovci. Bërbatovci është sulmues me përvojë të madhe pasi ka luajtur në klubet Prishtina, Liria, Llapi, Besa, së fundmi në KEK. Bërbatovci do t’i mbrojë ngjyrat kuq e zi për sezonin 2021/22”, thuhet në njoftimin e KF Vëllaznimi.

### Blerim Krasniqi nga Teuta kalon në Gjilan

Sport Club Gjilani ka njoftuar të enjten se ka arritur marrëveshje me skuadrën e Teutës për transferimin e futbollistit Blerim Krasniqi. “Marrëveshja e futbollistit dhe klubit tonë është e vlefshme për dy edicionet e radhës. Krasniqi luan rolin e sulmuesit të qendrës dhe ai ishte pjesë edhe në disa skuadra të tjera në Shqipëri. Të gjithë në klub i urojmë mirëseardhje Krasniqit, teksa falënderojmë KF Teutën për bashkëpunimin dhe korrektësinë”, thuhet në njoftimin e skuadrës së Gjilanit.

### Milani dhe Lazio, në garë për Shaqirin

Xherdan Shaqirin mund ta shohim sërish në Serinë A në sezonin e ri. Sulmuesi shqiptar po mendon për një aventurë të re, pasi nuk ka hapësira te “The Reds”. Igli Tare ka shfaqur më shumë interesim për ish-lojtarin e Interit, por së fundmi në skenë për të marrë shërbimet e 29-vjeçarit nga Gjilani ka dalë edhe Milani. Lazio qëndron në “pole-position” për të firmosur me Shaqirin, por vetë futbollisti preferon kuqezinjtë. Tashmë mbetet për t’u parë se te cili nga këto dy klube do të jetë e ardhmja e Xherdan Shaqirit.

## Përfundon ëndrra e Shalës për medalje në ‘Tokio 2020’

Prishtinë, 5 gusht - Ëndrra e mundësit të Kosovës, Egzon Shala, për t’u bërë atleti i parë mashkull nga Kosova që fiton medalje olimpike në “Tokio 2020”, mori fund të enjten, pasi Geno Petriashvilit e mposhti Amir Hossein Zare në një meç gjysmëfinal në të cilin i mbante shpresat suharekasi. Shala po e priste rezultatin e duelit gjysmëfinal mes Petriashvilit të Gjeorgjisë dhe Zares së Iranit dhe shpresat e tij për të mbetur në garë për medaljen e

bronzte vareshin nga një fitore e mundshme e këtij të fundit. Petriashvilit e mposhti Zaren në gjysmëfinale dhe e arriti finalen për medalje të artë në kategorinë -125 kilogramë. Shala u mposht pikërisht nga Amir Hossein Zare i Iranit në çerekfinale në kategorinë -125 kilogramë të enjten herët në mëngjes. 30-vjeçari nga Suhareka e kishte fituar luftën e parë ndaj algjerianit Djahid Berrahal, por disfata në çerekfinale nënkupton se ai

e humbi mundësinë për të luftuar për medalje të artë apo argjendte. Ai po shpresonte në fitore të iranianit Zare në gjysmëfinale për t’iu mundësuar garimi për medalje të bronzte. Shala ishte garuesi i fundit i Kosovës në “Tokio 2020”. Kosova u përfaqësua nga 11 atletë në Tokio, prej të cilëve dy fituan medalje të arta. Distria Krasniqi dhe Nora Gjakova e shkruan historinë duke fituar medalje të arta në kategoritë e tyre përkatëse në xhudo.



## Alidema, pas rikthimit te Llapi: Gabova që shkova te Drita

**PODUJEVË, 5 GUSHT** - Sulmuesi Festim Alidema është rikthyer në skuadrën e Llapi. Sulmuesi në fjalë, pas formës së mirë që kishte në këtë klub, arriti të transferohet në Kroaci te Slaven Belupo, megjithatë disa gjëra nuk shkuan si duhet atje dhe Festimi ishte

rikthyer prapë në Superligën e Kosovës. Alidema mbrojti ngjyrat e Dritës, por pa lënë gjurmë të mëdha. Pas një takimi me presidentin e klubit, Beqir Batatina, u arrit marrëveshja që Alidema të nënshkruajë me Llapi kontratë dyvjeçare me

mundësi vazhdimi edhe për një vit. "Gabimi më i madh imi pas rikthimit në Kosovë është që nuk iu riktheva skuadrës ku kisha shkëlqimin si futbollist. Tashmë u riktheva aty ku pata besimin dhe përkrahjen e gjithë qytetit, kryesisë, shtabit teknik, në veçanti

trajnerit Tahir Batatina. Po rikthehem në shtëpinë time të dytë, te qyteti dhe tifozët 'Legjendat' që më kanë përkrahur në vazhdimësi. Besimin e kryesisë dhe klubit garantoj se do t'ua shpërblej me angazhim maksimal", ka thënë Alidema.



## Sefaja: Kampionat i rëndësishëm për ne, do ta japim maksimumin

**PRISHTINË, 5 GUSHT** - Basketbollistët e Kosovës U16 po vazhdojnë përgatitjet për FIBA European Challenger që do të zhvillohet nga 16 deri më 21 gusht në Prishtinë. "Dardanët" e rinj janë të motivuar në stërvitje dhe atmosfera është shumë pozitive, derisa rëndësia është e dyfishtë, pasi do të zhvillohet në kryeqytetin e Kosovës. Përzgjedhësi i kësaj grupmoshe, Dritëro Sefaja, ka folur për rjedhën e përgatitjeve. "Kemi pasur më herët disa grumbullime, kurse prej të dielës kemi filluar fazën intensive, që do të mbahet deri para fillimit të garave. Kemi disa lëndime të lojtarëve, megjithatë po shpresoj se do të shërohen me kohë. Ekipi është i bashkuar dhe i motivuar. Atmosfera është shumë e mirë", është shprehur Sefaja për faqen zyrtare të FBK-së. Kampionati ka rëndësinë e veçantë, pasi zhvillohet në Prishtinë. "Është përparësi e madhe të luash si vendas. Megjithatë, për shumë lojtarë, kjo do të jetë hera e parë që luajnë në gara ndërkombëtare, andaj nuk do të jetë e lehtë. Do të punojmë edhe në



aspektin psikik, sepse ka shumë rëndësi", ka shtuar Sefaja.

Kosova është në grup me Shqipërinë, Maltën, Andorrën, Gjibraltarin dhe Luksemburgun. "Ne kemi dy vjet që nuk kemi garuar për shkak të pandemisë me Covid-19. Presim konkurrencë nga Shqipëria dhe Luksemburgu, pak më lehtë me shtetet e tjera. Ne do të mundohemi të

luajmë lojën tonë dhe ta japim maksimumin", përfundoi Sefaja.

Bordi i FIBA Evropës vendosi që të gjitha garat te gurrpomoshat e reja të zhvillohen në formë të Challenger, e jo më herët si divizione. Ky kampionat ishte dashur të zhvillohet në vitin 2019 në Prishtinë me pjesëmarrjen e 11 shteteve, por u shty për shkak të Covid-19.

## Dështimi i turpshëm i amerikanëve në 4x100 metra në Tokio

**TOKIO, 5 GUSHT** - Dështimi i ekipit amerikan të meshkujve për ta arritur finalen në garën e famshme 4x100 metra në Lojërat Olimpikë 2020 është duke u vlerësuar si turpërim i madh. Katërshja amerikane Trayvon Bromell, Fred Kerley, Ronnie Baker dhe Cravon Gillespie përfunduan në vendin e gjashtë në grupin e tyre gjysmëfinal me kohën 38.10 sekonda. Kjo kohë ishte e pamjaftueshme jo vetëm për të fituar medalje olimpikë, por edhe për ta arritur finalen në 4x100 metra. Prandaj, sprinteri legjendar amerikan Cal Lewis e ka quajtur plotësisht të turpshëm vrapimin e tyre. "Ekipi i ShBA-së bëri gjithçka gabim. Sistemi i pasimit të stafetës ishte gabim, atletët vraponin gabimisht dhe ishte e qartë se nuk ishte leadership", ka thënë Lewis. Kina e fitoi grupin me kohën 37.92 sekonda dhe Kanadaja doli e dyta dhe Italia e treta. Gjermania ishte e katërta dhe Gana e pesta, pra të gjitha para



ShBA-së në grup. Në një reagim në rrjetet sociale, Lewis e krahasoi ekipin amerikan me atletët e rinj amatorë të ShBA-së. "Ishte turpërim i madh dhe plotësisht e papranueshme për një ekip amerikan të duket më keq se

fëmijët e AAU-së (Unioni Atletikës Amatorë)", ka shkruar ai. Ekipi amerikan e ka fituar Kampionatin Botëror 2019 në stafetën 4x100 metra, por nuk ka fituar medalje të artë olimpikë në këtë garë që prej vitit 2000.

### SHKURT

#### Messi këtë fundjavë nënshkruan kontratën e re me Barçën

Lionel Messi do të jetë përfundimisht i Barcelonës. Argentinasi kthehet nga pushimet dhe pritet të firmosë kontratën e re me blaugranët gjatë fundjavës. Messi është në formë shumë të mirë pasi ka fituar Kupën e Amerikës Latine me Argentinën, duke hequr një peng që kishte prej vitesh për të fituar një trofe me përfaqësuesen e tij. Nga ana tjetër ai, është në moshën 34-vjeçare dhe do të vijojë karrierën te klubi ku u rrit dhe ka fituar gjithçka.

#### Matt Walls fiton të artën në omnium

Matt Walls nga Britania e Madhe i ka kaluar më së shpejti 100 rrahët në garën e meshkujve për ciklizëm në omnium, në Lojërat Olimpikë "Tokio 2020". Walls arriti të qëndronte në pozitën e parë për kohën më të madhe të garës, andaj edhe fundi nuk ishte ndryshe. Campbell Stewart i Zelandës së Re përfundoi garën i dyti për ta fituar medaljen e argjendtë, ndërsa Vivian, i cili ishte kampion në Rio 2016, doli i treti, për t'i mjaftuar e bronza.

#### Erikseni rikthehet në fushë pas 4 apo 5 muajve

Christian Eriksen u rikthye të mërkurën në Milano pas pothuajse dy muajsh mungesë duke takuar shokët e skuadër tek Interi, trajnerin Simone Inzaghi dhe drejtuesit e klubit. Ardhja e Eriksen në Milano do të përkohet me disa vizita të detajuara mjekësore që do t'i nënshtrohet danezi për të mësuar përfundimisht të ardhmen në futboll. Gazeta italiane "Corriere Dello Sport" ka zbuluar një frazë të rëndësishme të dalë nga goja e danezit: "Shkoi mirë vizita, do të kthehem të luaj për katër ose pesë muaj". Një lajm mjaft i mirë ky për futbollistin, por mister ngelet e ardhmja tek Interi pasi Erikseni nuk mund të luajë në Itali me defibrilator në zemër.

#### UEFA fut VAR-in në kualifikueset e Botërorit

UEFA është bindur totalisht nga aftësia e sistemit VAR dhe ka vendosur ta inkuadrojë në thuajse të gjitha aktivitetet futbollistike. Së fundmi, me pëlqimin e FIFA-s, UEFA ka vendosur që ta fusë sistemin VAR edhe në ndeshjet kualifikuese të Botërorit Katar 2022 që do të zhvillohen në shtator duke bërë një hap më tej në futboll. Në Evropian sistemi VAR ishte pothuajse perfekt duke pasur një përqindje shumë të vogël gabimi dhe, mesa duket, e ardhmja e futbollit do të jetë teknologjia.

## Guardiola: Lukaku, sulmues i nivelit botëror

Pep Guardiola është dikush që nga sulmuesit merr vesh, spanjollit ka drejtuar shumë yje në karrierën e tij, nga Leo Messi e deri te Sergio Aguero. Trajneri i Manchester Cityt, teksa diskutohet për një rikthim të mundshëm

të Romelu Lukakut në Premierë Ligë, te Chelsea, nuk i kursen lëvdatat për belgun duke e konsideruar një ndër sulmuesit më të mirë në botë. "Lukaku kur ishte 24 vjeç kishte shënuar 100 gola në Premierë Ligë, jo keq apo jo. Pastaj në pasimet e

gjata e dimë se çfarë bën, është i shpejtë dhe i fortë. E kam parë kur luante me Evertonin me mikun tim Ronald Koeman, na ndëshkoi brenda në 'Etihad Stadium' dhe na ndëshkoi edhe në 'Goodison Park'. Është i shpejtë, të

ndihmon të mbash topin, po ashtu jep një ndihmesë të marrë për të bërë lëvizjet me lojtarët e tjerë, në këtë aspekt është më i miri. Mund ta konsiderojmë pa frikë një sulmues të nivelit botëror", ka thënë Guardiola.



KOMPANIA REGJIONALE E MBETURINAVE  
REGIONAL WASTE COMPANY  
REGIONALNA KOMPANIJA ZA UKLANJANJA OTPADA

Tel.+381(0)390/321 588  
+381(0)390/324 034  
www.cabrati.com  
e-mail. info@cabrati.com  
Gjakovë - Gjakova

**K.R.M. "ÇABRATI"**

KOMPANIA RAJONALE E MBETURINAVE "ÇABRATI" SH.A. GJAKOVË, duke u bazuar nenin 7 dhe 8 të Ligjit të Punës (Ligji Nr. 03L/212) dhe gjendjes momentale dhe nevojave të kompanisë për plotësim të vendeve të punës për periudhën e ardhshme një vjeçare, dhe Vendimit Nr. 84 me Nr. Protokollit datës 04.08.2021 të Kryeshefi Ekzekutiv, u vendos që me datë 05.08.2020 të shpallët:

## Konkurs publik

Për këto pozita:

### I. INKASANT

**Numri:** 1 /një/ INKASANT me kohë të caktuar ( me kohëzgjatje 1 /një/ vjeçare), me mundësi vazhdimi, por që 6/ gjashtë/ muajt e parë do të jetë në punë provuese.

**I përgjigjet:** Koordinatorit Faturimit dhe Inkasimit.

**Vendi:** Gjakovë.

**Kushtet:**

1. Të posedojnë nivelin e shkollimit: Shkollë e Mesme preferohet drejtimi ekonomik,
2. Të ketë më së paku 1 (një) vite përvojë të punës relevante,

**Kushtet e veçanta:**

1. Të ketë njohuri profesionale ose të ngjashme,
2. Të mos jetë i dënuar apo nën hetime,
3. Të ketë aftësi të mira psikofizike për punë me ngarkesa dhe përballje me kushtet në terren që kërkon vendi i punës,
4. Preferohet posedimi i patentë shoferit me "B" kategori më së paku.

**Dokumentet e kërkuara:**

Kërkesa, CV-ja, Diploma, Referenca e përvojës 1 (një) vit në punët relevante, Raport mjekësor se posedon aftësi të mira shëndetësore për pozitën që konkurron, Vërtetimin e Gjykatës që nuk është i/e dënuar ( më e re se gjashtë muaj), preferohet të posedoj patentë shoferin me kategori "B" dhe Letër Njoftimi.

### II. Punëtorë fizik sezonal, me kohë të caktuar

**Numri:** 2 /dy/

**I përgjigjet:** Menaxherit të Operativës.

**Vendi:** Gjakovë.

**Kushtet dhe kualifikimet e kërkuara:**

**Kushtet e përgjithshme:**

- Të ketë përgatitje- Shkollim Fillor i domosdoshëm;
- Të ketë së paku një (1) vit përvojë pune;

**Kushtet e veçanta:**

- Të jetë në gjendje të miri shëndetësore,
- Të mos jetë i/e dënuar ose nën hetime (jo më e vjetër se 3 muaj).

**Kandidati/ja duhet t'i dorëzojë këto dëshmi:**

- Aplikacionin,
- CV-në,
- Dëshminë e shkollimit,
- Dëshminë për përvojën e punës,
- Certifikatën që nuk është nën hetime (jo më e vjetër se 3 muaj),
- Certifikata e mjekut, preferohet.

**Paga për këto të dy pozitat:** Në pajtim me politikën e kompensimit të aprovuar nga Bordi i Drejtorëve.

**Detyrat e punës:** Për të këto pozita detyrat e punës mund t'i gjeni në veb faqen e kompanisë [cabrati.com](http://cabrati.com)

Afati i paraqitjes së kërkesave për këto dy pozita është 15 ditë nga dita e publikimit, ( nga data 05.08.2021 e deri me datë 19.08.2021 ora 16:00).

Kërkesën me dokumentacionin e kërkuara, kandidatet duhet t'i dorëzojnë në drejtorin e KRM."Çabrati" SH.A. në Gjakovë, Rr."Mazllom Lakuci" pn. (tek sekretaria- Menaxheri i Burimeve Njerëzore). Dokumentet pa afat dhe të pakompletuara nuk do të merren për bazë.

Pas kalimit të afatit të konkursit, kandidatet i nënshtrohen procedurës së të testit dhe intervistës.

## >> SHPALLJE TË VOGLA <<

► Shehrije Berisha shpall të pavlefshme diplomën e SH.M.A.P " Hysni Zajmi" Gjakovë

► Petrit Lluhani shpall të pavlefshme diplomën e Gjinnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

► Feraset Asllani, Berjahë Gjakovë, shpall të pavlefshme dëftesën e plotë SH.M.M.U. "Bajram Sadriu" Berjahë.

► Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokal në qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

► Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

► Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

► Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.

► Lëshoj banesën e re me qira në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 Euro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

► Lëshoj banesë me qira, penthouse. Banesa gjendet te Rrethi i Veternikut në Prishtinë. Banesa ka 150 m2, dhe ka 3 dhoma, dy banjo, 2 garazha si dhe shpajz. Për info mund të na kontaktoni në këtë numër të tel: 049-440-466.

► Lëshoj banesën një dhomshe me qira, ne lagjen Dardania afër Postës Kryesore (posta e Madhe) Kroji i Bardhe, banesa është e mobiluar tërësisht. Për informata lajmërohuni në tel: 044/558-894 Prishtinë.

► Lëshoj me qira banesën e mobiluar te salloni i mobileve "ALBED" në Fushë Kosovë. Banesa i ka 65 metra katrorë dhe është e gatshme për banim. Më shumë informata në: 044/706-079.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen "Ulpiana" në Prishtinë, afër AAK-së. Banesa është e mobiluar komplet. Për informata mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 044-162-783, si dhe në të njëjtin numër në viber.

► Kërkojmë 4 bashkëbanuese, studente, banesa gjendet te Parku i qytetit, kati i I-rë, ka 3 dhoma, banjo, ballkon, çmimi për person është 50 euro plus shpenzimet. Për info: 045/699-221.



## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Caseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

